



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë - Ministarstvo za Obrazovanje, Nauku i Tehnologiju - Ministry of Education, Science and Technology

KOSOVË: PROJEKTI PËR PËRMIRËSIMIN E SISTEMIT TË ARSIMIT

GRANTET PËR ZHVILLIMIN E SHKOLLAVE (GZHS)

KONKURS PËR PROJEKT-PROPOZIME PËR GRANTE SHKOLLORE

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi prej grupit të Bankës Botërore për zbatimin e projektit për Përmirësimin e Sistemit të Arsimit (ESIP) dhe ka për qëllim që një pjesë të mjeteve të këtij granti ta përdor për t'i mbështetur shkollat fillore (klasat 0-9) në Kosovë përmes këtij konkursi.

Qëllimi i këtyre granteve është forcimi i kapaciteteve të shkollave për të planifikuar dhe për t'i menaxhuar mjetet, si dhe për ta promovuar angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimitdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës. Për këto grante do të konsiderohen ato projekt-propozime që janë në përputhje me këtë qëllim dhe me kushtet e përcaktuara në doracakun e granteve për zhvillimin e shkollave (GZSh).

Në kuadër të këtij konkursi, MASHT-i do t'i financojë 80 shkolla me shumën deri në 15,000 USD për një shkollë.

Buxheti për grante për vitin 2020 është 1.200.000 USD

Buxheti do të shpërndahet në dy kategori:

1. **Materiale didaktike (60%):** përfshirë pajisje të laboratorit, mjete demonstruese, mjete të mësimitdhënies si dhe TI (blerjet për Laptop/kompjuter nuk mund të kalojnë 20% të kësaj shume), dhe
2. **Shërbime (40%):** përfshirë aktivitetet për përmirësimin e cilësisë, zhvillimin profesional të stafit dhe organizimin e aktiviteteve që ndërlidhen me përmirësimin e mësimitdhënies dhe mësimitdhënies.

Ftohen shkollat e interesuara që të aplikojnë me projekt propozime.

Afati për dorëzimin e projekt propozimeve:

Afati për dorëzimin e projekt propozimeve është deri me datë *15 Janar 2020, ora 16.00.*

Një sesion i hapur informues do të mbahet me datë 24 Dhjetor 2019 në ora 11.00 në MASHT në Prishtinë.

Kush ka të drejtë të aplikoj?

Të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të ulëta të cilat posedojnë plan zhvillimor të shkollës kanë të drejtën e aplikimit.

Kriteret e vlerësimit:

Projekt propozimet do të vlerësohen në bazë të tetë kriterëve si vijon:

- 1) qëllimi; 2) ndikimi; 3) edukimi; 4) koherenca; 5) qëndrueshmëria; 6) fizibiliteti;
- 7) gjithëpërfshirja dhe 8) aspekti teknik.

Çdo projekt propozim do të vlerësohet kundrejt secilit prej këtyre tetë kriterëve në një shkallë prejpesë pikësh (0 shumë i dobët – 4 i shkëlqyeshëm).

Më shumë informata rreth kriterëve mund t'i gjeni në Doracakun e GZSHH-së tek Neni 7.1 ose Shtojca 1: Fleta për vlerësimin e granteve, e bashkëlidhur në këtë thirrje.

Procesi i vlerësimit:

Projekt propozimet vlerësohen dhe miratohen nga komisioni vlerësues i cili themelohet nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Udhëzime specifike:

Formulari për projekt propozim i bashkëlidhur kërkon *përshkrim të detajuar të aktivitetëve* të ndërlydhura me kriteret.

Listën e aktivitetëve pozitive dhe negative mund ta gjeni në Doracakun e GZSHH-së Nenet 7.2.1 dhe 7.2.2 ose Shtojcën Lista e aktivitetëve pozitive dhe negative, e bashkëlidhur në këtë thirrje

Procedurat e aplikimit:

Dorëzimi i projekt propozimit mund të bëhet në kopje fizike në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Kati i IV, Rr. “Agim Ramadani”, p.n. 10000 Prishtinë, Kosovë, apo me email tek gzhsh.kesip@gmail.com.

Për më shumë informata telefononi në: +383 (0) 38 20020114.